



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-Ministarstvo Trgovine i Industrije-Ministry of Trade and Industry
Kabineti i Ministrit-Kabinet Ministra-Cabinet of the Minister

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA			
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA			
MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIJË - MINISTARSTVO TRGOVINE I INDUSTRIJE - MINISTRY OF TRADE AND INDUSTRY			
Njësi Org. Org. Jecinka Org. Unit	01	Nr. Prot. Broj. Prot. Prot. No.	3015
Nr. i faqeve Broj. stranica No. of pages	02	Data Datum. Date	18.06.2020

01.Ref. Nr.01
Prishtinë, 18.06.2020

Ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (MTI), në mbështetje të neneve 10, 11 dhe 17 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, nenit 8 paragrafi 1.4 dhe shtojcës 8 pikat 20, 30 e 31 të Rregullores (QRK) nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, duke pasur parasysh kërkesat e Planit Kombëtar të Reagimit, rekomandimet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike dhe Manualin për mbrojtje nga përhapja e virusit COVID-19, nxjerr këtë:

URDHËRESË

Për aplikimin e masave për parandalimin dhe luftimin e COVID-19 në sektorin e gastronomisë

- Urdhërohen të gjithë operatorët ekonomikë të sektorit të gastronomisë që sipas kësaj urdhërese të marrin këto masa higjienike dhe parandaluese:
 - Distanca nga ulësja në ulësen prapa shpinës, jo më pak se 1.5 metra.
 - Distanca në mes të ulëseve brenda tavolinës të jetë së paku 1 metër.
 - Të mos ulen më shumë se 4 persona në një tavolinë, përveç nëse janë anëtarë të së njëjtës bashkësi familjare.
 - Të ketë dezinfektantë të qasshëm lehtë nga klientët në çdo lokal.
 - Stafi të jetë i pajisur me maska mbrojtëse.
 - Të mos shërbehet në banak.
 - Servimi i tavolinave (vendosja e thikave, pirunëve, lugëve, etj.) të bëhet bashkë me shërbimin e porosisë.
 - Menyja të jetë për një përdorim ose të jetë e tillë që të mund të dezinfektohet pas çdo porosisë.
 - Të bëjë dezinfektimin dhe ajrosjen e rregullt të lokaleve dhe hapësirave të punës.
 - Të publikohet në çdo lokal manuali për mbrojtje nga përhapja e virusit COVID-19 i përgatitur nga Ministria e Shëndetësisë.
- Kjo urdhëresë hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Veseli KRASNIQI

Ministër



Vendimi i dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit të MTI-së
- Zyrës së Kryeministrit
- Zëvendëskryeministrave
- Të gjithë ministrave (ministrive)
- Sekretarit të Përgjithshëm
- Inspektoratit të Tregut

- Inspektoratit të Punës
- Inspektorateve komunale
- Departamentit Ligjor
- Arkivit